




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPK</u>	Nr. Prot. <u>03-02/4842/16</u>
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/4842/16</u>
Nr. l faq.	Data <u>21.12.2016</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>21.12.2016</u>
Nr. pages	Date <u>21.12.2016</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.12.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3375/16, për z. Ekrem Hyseni, Drejtor i Onkologjisë në Qendren Klinike dhe Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ekrem Hyseni, Drejtor i Onkologjisë në Qendren Klinike dhe Universitare të Kosovës, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi njoftuar zyrtarin e lartë me fakte për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni (15 paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.*

Zyrtari i lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të largohet nga funksioni menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4800/16), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat Ordinanca Specialistike “Onkologjia”. Me këtë rast zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)



Shqip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit